



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 17 shkronjat e dhe f të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 30 parag. 1.3 të Ligjit për Borxhet Publike, nr.03/L-175 dhe nenit 19 shkronjat e dhe f të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 06 dhjetor 2016, mori

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN KUSHTEVE TË KREDISË AFATGJATE NGA QEVERIA E AUSTRISË PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT – NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR PËR UJËRA TË ZEZA NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Kredia afatgjate nga Qeveria e Republikës së Austrisë për realizimin e projektit – Ndërtimi i kolektorit kryesor për ujëra të zeza në Komunën e Podujevës, mbështetur në Marrëveshjen për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministri i Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së Austrisë, përfaqësuar nga Ministri Federal i Financave të datës 12.07.2012 dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për aprovimin e Listës së Projekteve për Financim përmes Klauzolës së Investimeve, nr. 04/105 të datës 19.08.2016, autorizohet sipas kushteve në vijim:

- 1.1 Kredia në shumën 5,300,000.00 € (Pesëmillionetreqindmijë euro).
- 1.2 Norma e interesit 0% .
- 1.3 Forma e kredisë, Financim i projekteve përmes Klauzolës së investimeve, kredi e butë.
- 1.4 Kthimi i kredisë do të bëhet pas 6 viteve përkatësisht, periudhës së hirtë (grejs periudhës) 4 vjeçare dhe periudhës së finalizimit të punimeve që është paraparë në kohëzgjatje 2 vjeçare, në këste proporcionale gjashtëmujore.
- 1.5 Qëllimi i kredisë është financimi i projektit – Ndërtimi i kolektorëve:
 - 1.5.1 Kolektori Lluzhan – Lupç i Poshtëm – 7.0 km.
 - 1.5.2 Kolektori Lluzhan - Podujevë – Bradash – 18.7 km.
 - 1.5.3 Kolektori Lluzhan – Gërdoc – 8.9 km.
 - 1.5.4 Kolektori Llugë – Sfeçël – 6.9 km.
 - 1.5.5 Kthimi i kredisë do të bëhet nga buxheti i Komunës së Podujevës.

Neni 2

Sipas Marrëveshjes, garantuese e kredisë është Republika e Kosovës - Ministria e Financave e cila do të garantoj në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushtëzime përmbushjen e të gjitha pagesave që dalin nga kredia përkatëse.

Neni 3

Pjesë përbërëse e Vendimit është projekti zbatues, Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza në Komunën e Podujevës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr.01-006-88064

Podujevë,

06 dhjetor 2016

